

20152316466

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR AKADEMI PËR GJYKATËS
DHE PROKURORË PUBLIKË

Neni 1

Në Ligjin për Akademi për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/15 dhe 192/15), në nenin 12 paragrafi (3), nenin 20 paragrafi (5), nenin 37 paragrafi (6), nenin 45 paragrafi (5) presja pas fjalës „BULLATS“ dhe fjalët: „ose Aptis“ shlyhen.

Neni 2

Në nenin 57 paragrafi (1) alineja 7 presja pas fjalës „BULLATS“ dhe fjalët: „ose Aptis“ shlyhen.

Pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2), si vijon:

„(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, për plotësimin e numrit të nevojshëm të prokurorëve publikë për realizimin e kompetencës së tyre në pajtim me ligj, në trajnimin fillestar si kandidatë për prokurorë publikë, mund të pranohen edhe kandidatët që i plotësojnë kushtet në vijim:

- jurist i diplomuar me arsim të lartë katërvjeçar të mbaruar shkalla VII/I në studime juridike me mesatare prej së paku 7,0 ose jurist i diplomuar me 300 kredi të fituara sipas Sistemit evropian për transferim të kredive (SETK), me mesatare prej së paku 7,0 në studime universitare, provim të dhënë të jurisprudencës dhe me stazh pune prej së paku pesë vite pas dhënies së provimit të jurisprudencës në gjykatë apo në prokurori publike si nëpunës gjyqësor apo nëpunës i prokurorisë publike apo avokat,

- të mos i jetë shqiptuar masa e sigurisë, ndalimi i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,

- aktivisht ta zotërojë gjuhën maqedonase,

- në mënyrë aktive ta njohë njërën nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian, nga të cilat detyrimisht gjuhën angleze që dëshmohet me posedim të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testuesi zyrtar evropian, anëtar i Shoqatës ALTE të testuesve evropianë të nivelit B2 (B2) të CEFR (CEFR), përkatësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEK V, ILEK, IKFE, BULLATS; ose TOEFELL PBT së paku 500 pikë, TOEFELL CBT së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë, ose DELLF, TCF, TEF, ose Gete Certifikatë, TestDaF,

- punë praktike me kompjuterë dhe

- të jetë i aftë për punë dhe të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore.”

Në paragrafin (2) i cili bëhet paragrafi (3) pas fjalëve: „alinetë 8 dhe 9“ shtohen fjalët: „ dhe paragrafi (2) alinetë 6 dhe 7“.

Neni 3

Në nenin 94 pas paragrafit (3) shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

„(4) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, trajnimi fillestar për dëgjuesit nga neni 57 paragrafi (2) zhvillohet në një fazë – mësim teorik në Akademi në kohëzgjatje prej nëntë muajsh.“

Neni 4

Dispozitat nga neni 2 paragrafët (2) dhe (3) dhe neni (3) të këtij ligji me të cilat plotësohen nenet 57 dhe 94 të Ligjit për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë do të zbatohen një vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".